



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës  
+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjja "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogovic  
10 000, Prishtina

# RREGULLORE E GARAVE FEDERATA E BASKETBOLLIT E KOSOVËS

## EDICIONI 2022/23 28/07/2022, Prishtinë

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## PËRMBAJTJA

### ***KAPITULLI - I - DISPOZITAT THEMELORE***

**Neni 1 – 8 .....1-3**

### ***KAPITULLI - II - SISTEMI DHE KALENDARI I GARAVE***

**Neni 9 – 11 .....3**

### ***KAPITULLI - III - ORGANIZIMI I NDESHJEVE***

**Neni 13 – 21 .....4-5-6**

### ***KAPITULLI - IV – PLASMANI I EKIPEVE***

**Neni 22 – 23 .....6-7**

### ***KAPITULLI - V – ORGANIZATORI I NDESHJES***

**Neni 24 .....7**

### ***KAPITULLI - VI – E DREJTA E GARIMIT***

**Neni 25 – 46 .....8-12**

### ***KAPITULLI - VII – PERSONAT ZYRTARË NË NDESHJE***

**Neni 47 – 48 .....13**

### ***KAPITULLI - VIII – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE***

**Neni 49 – 52 .....14**

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## 1. DISPOZITAT THEMELORE

### Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat për organizim, zbatim dhe administrimi i të gjitha garave në kuadër të Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: FBK).

### Neni 2

Kjo Rregullore i përcakton rregullat themelore për të gjitha garat dhe paraqet bazën për zgjedhjen e të gjitha çështjeve në lidhje me gara.

#### **Garat e basketbollit organizohen për:**

- 2.1. Sportistët/et, të cilët aktivitetin e tyre si basketbollistë/e e realizojnë në mënyrë amatore;
- 2.2. Sportistët/et, të cilët aktivitetin e tyre si basketbollist/e e realizojnë në mënyrë profesionale.

### Neni 3

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të gjithë pjesëmarrësve në gara, marrëdhëniet e tyre reciproke, të drejtat dhe obligimet e personave zyrtarë në gara, veçoritë në disa gara, si dhe çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me gara, përcaktohen me dokumente të posaçme: Propozicione të Garave, që duhet të jetë në harmoni me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

E drejta e garimit të cilitdo anëtar të FBK-së në garat e organizuara nga FBK-ja do t'i mohohet nëse klubi ka çfarëdo borxhi të dokumentuar ndaj FIBA-s, FIBA Evropës, apo ndonjë entiteti tjetër përgjegjës për organizimin e garave ndërkombëtare të basketbollit të njohur nga FIBA.

Obligimet ndaj FBK-së për edicionin paraprak duhet të paguhen si përmbushje e kriterëve për licencim për edicionin e ri të garave 2022/23. 50% (pesëdhjetë përqind) e obligimeve të edicionit paraprak duhet të kryhen si përmbushje e kriterëve, kurse pjesa tjetër e borxhit duhet të programohet dhe të paguhet konform marrëveshjes së përgatitur nga FBK dhe nënshkruar nga të dyja palët.

Mos përmbushja e afateve të marrëveshjes për shlyerje të borxheve rezulton me suspendim të klubit deri në shlyerje të borxheve sipas afateve të përcaktuara në marrëveshje.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Asnjë anëtar i FBK-së nuk do të mund të marrë pjesë në garat e organizuara nga FBK në rast se FBK është ngarkuar me çfarëdo dënimi, gjobë, pagesë, faturë apo ngarkesë tjetër si rrjedhojë e veprimit apo mosveprimit të klubit në fjalë kundrejt obligimeve të veta ndaj FIBA-s, FIBA Evropës, apo cilitdo entiteti tjetër përgjegjës për organizimin e garave ndërkombëtare të njohura nga FIBA. E drejta për të marrë pjesë në gara mund të rifitohet pas kompensimit nga klubi të të gjitha pagesave dhe shpenzimeve të tjera administrative, të cilat i janë ngarkuar FBK-së si rrjedhojë e veprimit apo mosveprimit të klubit sipas këtij Neni.

#### Neni 4

Udhëheqja e të gjitha garave në territorin e Republikës së Kosovës është në autorizim të Bordit të FBK-së. Për udhëheqjen e drejtpërdrejt të garave Bordi i FBK-së emëron Komisionin e Garave, i cili udhëheq me të gjitha garat e seniorëve dhe senioreve, kurse për garat e kategorive të reja Bordi i FBK-së e emëron Komesarin e Garave të Kategorive të Reja, i cili udhëheq me të gjitha garat e kategorive të reja.

#### Neni 5

Të gjitha garat zhvillohen në harmoni me dispozitat e Rregullave zyrtare të Basketbollit të nxjerra nga Federata Ndërkombëtare e Basketbollit – FIBA, interpretimin e të cilave e jep FIBA Instruktori Nacional i FBK-së në Republikën e Kosovës.

#### Neni 6

Komisioni i Garave i përgatit Propozicionet e Garave në bazë të dispozitave të kësaj Rregulloreje, për të gjitha garat e kategorive për seniorë e seniore, kurse Komesari i Garave për Kategoritë e Reja i përgatitë PG të kategorive të reja. Propozicionet e Garave i miraton Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

#### Neni 7

Klubet janë të obliguara që të kryejnë kontrollin dhe mbrojtjen shëndetësore të lojtarëve dhe trajnerëve.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## Neni 8

Klubi, lojtari (lojtarët) i të cilit merr pjesë (marrin pjesë) në përbërje të cilësdo Përzgjedhje Nacionale, ka të drejtë të kërkojë shtyjë ndeshjen kampionale apo të Kupës. Për shtyrjen eventuale të ndeshjes, vendos Komisioni i Garave, në bazë të Propozicioneve të Garave dhe kësaj rregulloreje.

## 2. SISTEMI DHE KALENDARI I GARAVE

### Neni 9

Sistemin e garave në të gjitha nivelet e Republikës së Kosovës dhe numrin e ekipeve pjesëmarrëse për çdo nivel veç e veç e përcakton Bordi i FBK-së, në propozim të Komisionit të Garave.

Vendimi mbi sistemin e garave duhet të merret para fillimit të edicionit garues. Sistemi i garave inkorporohet në Propozicioneve të Garave.

Në raste të shfaqjes së fuqisë madhore, përfshirë mes tjerash fatkeqësitë natyrore, epidemitë dhe pandemitë, gjendjen e jashtëzakonshme, gjendjen e emergjencës shëndetësore si dhe çfarëdo situatë të ngjashme që rezultojnë me nevojën për të ndërprerë garat, Bordi i FBK-së mund të bëjë ndryshimin emergjent të sistemit të garave.

### Neni 10

Para fillimit të edicionit, bëhet hedhja shortit dhe në bazë të shortit përcaktohet kalendari, për secilin rang garues.

Numrat garues të klubeve përcaktohen me anë të tërheqjes së shortit para fillimit të garave apo edhe sipas renditjes në edicionin e kaluar.

### Neni 11

## Kupa e Kosovës

Ndeshjet e Kupës së Kosovës zhvillohen sipas Propozicioneve të Kupës të cilat përgatiten nga Komisioni i Garave dhe aprovohen nga Bordi i FBK-se para fillimit të edicionit.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





### 3. ORGANIZIMI I NDESHJEVE

#### Neni 12

Garat kampionale dhe garat për Kupë në kategoritë e seniorëve-eve i administron Komisioni i Garave, si organi i autorizuar i garave nga ana e Bordit të FBK-së.

#### Neni 13

Komisioni i Garave bën regjistrimin e të gjitha ndeshjeve të zhvilluara, përveç të atyre në të cilat është parashtruar ankesa. Ndeshja në të cilën është parashtruar ankesa do të regjistrohet pas vendimit të marrë sipas ankesës.

#### Neni 14

Ankesa në ndeshje paralajmërohet me nënshkrimin e kapitenit të ekipit në protokollin e ndeshjes. Plotësimet në ankesë i dorëzohen vëzhguesit të ndeshjes.

#### Neni 15

Duke vepruar sipas ankesës, Komisioni i Garave ankesën mund ta miratojë apo ta refuzojë. Nëse ankesa miratohet, ndeshja anulohet dhe caktohet termini i ri për zhvillimin e ndeshjes. Nëse ankesa refuzohet, Komisioni i Garave do ta regjistrojë ndeshjen me rezultatin e arritur. Ankesa e cila nuk është dorëzuar me kohë, refuzohet dhe nuk do të shqyrtohet. Vendimin për ankesën e ndeshjes, Komisioni duhet ta marrë më së voni 72 orë pas përfundimit të ndeshjes. Në ndeshjet e play-offit, turnetë finale apo tempoja e zhvillimit të ndeshjeve e cila kërkon reagim të shpejtë, Komisioni i Garave vendimet duhet t'i sjellë në afat prej 24 orëve pas përfundimit të ndeshjeve, e me këtë duhet të dorëzohen të gjitha dokumentet e nevojshme (ankesa, deklaratat e akterëve, personave zyrtarë etj), duhet t'i dorëzohen Komisionit të Garave në afatin e cekur.

#### Neni 16

Njëherë ndeshja e regjistruar apo vendimi i marrë nuk mund të anulohet nga ana e organit të njëjtë.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## Neni 17

Në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa në shkallën e dytë deri në Komisionin Arbitrar të FBK-së, e cila dorëzohet në afat prej tri (3) ditësh pas marrjes së vendimit. Komisioni Arbitrar vendimin e merr në afat prej 48 orëve. Vendimi i Komisionit Arbitrar është përfundimtar dhe pa të drejtë ankese.

## Neni 18

Me Propozicionet e Garave detajisht është përcaktuar procedura e deponimit të ankesës, si dhe afatet e përcaktuara në rastin e ankesës. Sipas Propozicioneve të Garave detajisht janë përcaktuar obligimet e organizatorit të ndeshjes, të cilat nuk mund të jenë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

## Neni 19

Për të gjitha shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Propozicioneve të Garave, vendos Komisioni i Garave, i cili mund të jap dënime për të gjitha rastet kur konstaton shkelje të kësaj Rregulloreje, Propozicioneve të Garave dhe Rregullores Disiplinore të FBK-së.

## Neni 20

Ndeshja e cila nuk është zhvilluar për shkaqe të arsyeshme:

- Ndërprerja e rrymës elektrike
- Ndërprerja e komunikacionit
- Fatkeqësive nga moti i ligë të vërtetuara nga enti shtetëror hidro-meteorologjik;
- Situatat e përcaktuara me ligj për fatkeqësitë natyrore (zjarri, përmytjet, rreziku, etj);
- Epidemia e publikuar nga institucioni i autorizuar shtetëror;

Atëherë ajo ndeshje duhet të zhvillohet brenda 24 orëve, nëse delegati e konstaton se një gjë e tillë është e mundur.

Nëse ndeshja është ndërprerë për shkak të defektit apo mosfunksionimit të aparaturës teknike në sallë, të cilat nuk mund të mënjanojnë apo të rregullohen, apo janë pasojë e fatkeqësive mbinatyrore, ndeshja duhet të zhvillohet brenda 24 orëve.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Ndeshja e ndërprerë do të vazhdohet nga momenti i ndërprerjes, nga rezultati i arritur, koha e mbetur e ndeshjes dhe rosteret e ekipeve të shënuara në protokoll të ndeshjes së ndërprerë.

Nëse nuk ka kushte për zhvillim të ndeshjes, për shkak të lëshimeve organizative, procedurat për zhvillim të ndeshjes, saktësohen në Propozicione të Garave.

## Neni 21

Klubi mund të kërkojë shtyrjen e ndeshjes së caktuar, nëse ka argumente të arsyeshme të mbështetura me dokumente më së paku 3 ditë nga dita e zhvillimit të ndeshjes. Në këtë afat, është e lejuar shtyrja e ndeshjes vetëm në këto raste:

- 21.1. Faktet e argumentuara për shtyrje;
- 21.2. Pëlqimi i lejimit në formë të shkruar nga ekipi kundërshtar;
- 21.3. Lejimi nga ana e Komisionit të Garave;
- 21.4. Shtyrja e ndeshjes nuk është e lejuar në afat më shkurtër se tri (3) ditë, nga dita e caktuar e zhvillimit të ndeshjes, përveç:
  - 21.4.1. Nëse nga institucioni i autorizuar shtetëror është publikuar sëmundja nga epidemia.

## 4. PLASMANI I EKIPEVE

### Neni 22

Plasmani i ekipeve në gara përcaktohet në bazë të Rregullave Zyrtare të Lojës dhe Propozicioneve të Garave. Në përputhje me suksesin në garën e caktuar, ekipet kalojnë prej një rangu në rangun tjetër. Në rast që klubi i një rangu të caktuar heq dorë nga garat para fillimit të kampionatit, apo vjen deri te zgjerimi i Ligës, për mënyrën e plotësimit eventual vendos Bordi i FBK-së. Me sistemin e garave definohet mënyra e përcaktimit të kampionit, rëniet nga ligat dhe plotësimet e tyre në të gjitha nivelet e garave. Gjithashtu, me sistemin e garave përcaktohet edhe mënyra e fituesit të Garave të Kupës së Republikës së Kosovës.

Kampioni i Kosovës, Fituesi i Kupës së Kosovës e fitojnë të drejtën të përfaqësojnë Kosovën në garat e FIBA-s. Për ekipet tjera që mund të përfaqësojnë Kosovën në gara FIBA-s, apo gara tjera ndërkombëtare, vendos Bordi i FBK-së.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:







Ekipit kampion të Superligës (meshkuj/femra) dhe fituesit të Kupës së Kosovës u takon shpërblimi financiar vlerën e së cilit e cakton Bordi i FBK-së para fillimit të edicionit. Bordi i FBK-së para fillimit të edicionit mund të vendosë edhe për shpërblime ose fonde të shpërblimeve që përfshijnë edhe klubet ose ligat tjera.

## Neni 23

Në varshmëri nga suksesi në gara, ekipet kalojnë nga niveli më i lartë në nivel më të ulët dhe nga niveli më i ulët në atë më të lartë. Skuadra e cila në fund të sezonit kalon në nivel më të ulët, në sezonin e ardhshëm nuk mund të kthehet, gjegjësisht të garojë në nivelin e njëjtë të garave. Përrjashtim nga ky rast bëhet nëse ekipet nga rangu më i ulët nuk i plotësojnë kushtet e garimit për nivel më të lartë, ose përcaktohen kushte për Ëild Card nga Bordi i FBK-së.

Ekipi i cili është përrjashtuar nga garat para fillimit apo gjatë sezonit të garave, nuk mund në sezonin e ardhshëm të kthehet dhe të garojë në nivelin e njëjtë, përveç nëse përcaktohen kushte për Ëild Card nga Bordi i FBK-së.

## 5. ORGANIZATORI I NDESHJES

### Neni 24

Organizator i ndeshjes është ekipi vendës. Klubet janë të obliguara që para fillimit të edicionit të lajmërojnë sallën ku do të zhvillojnë ndeshjet dhe sallën alternative, që po ashtu duhet ti përmbushë kushtet teknike sipas Propozicioneve të Garave.

Organizatori është përgjegjës për organizim të ndeshjes konform kësaj Rregulloreje, Propozicioneve të Garave, Ligjit mbi Tubimet Publike, Ligjit për Parandalim të Dukurive Negative në Sport dhe ligjeve e akteve tjera normative në fuqi.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## 6. E DREJTA E GARIMIT

### Neni 25

Të drejtë paraqitjeje në ndeshje dhe gara zyrtare të FBK-së kanë të gjithë lojtarët që posedojnë licencë dhe kanë kaluar kontrollin mjekësor. Klubet janë të obliguara që në ndeshje të paraqiten me përbërje më të mirë. Për mosrespektimin e kësaj pike, trajneri dhe personi zyrtar (përfaqësuesi zyrtar apo kryetari) i klubit do t'i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore.

### Neni 26

Për çdo edicion garues, Bordi i FBK-së mund të caktojë kufirin e moshës për të drejtë garimi në Ligën e Parë dhe të Dytë të Meshkujve.

### Neni 27

Në garat në kompetencë të Federatës, mund të marrin pjesë klubet. Në rangjet garuese të seniorëve një klub, mund të marrë pjesë me vetëm një ekip. Në rangjet garuese të juniorëve (U18) kadetëve (U16) dhe pionerëve (U14) klubi mund të marrë pjesë me nga dy skuadra. Klubi mund të bartë të drejtën e pjesëmarrjes në rangun e caktuar të garave, në klubin tjetër në përputhje me rregulloret përkatëse të Federatës.

### Neni 28

Në garat në kompetencë të Federatës, klubet me shkrim, në formularin e caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Federatës (Rregullorja për Licencim dhe Garim), lajmërohen për gara në të cilat në bazë të plasmanit kanë realizuar të drejtën e garimit.

Çdo ekip i Superligës për Meshkuj për edicionin 2022-23 është i obliguar që më ekipet e U14, U16, U18 të marrë pjesë në garat e Federatës për grupmoshat e reja.

Ekipi së bashku me formularin e paraqitjes, duhet ti paraqet edhe dëshmitë për plotësimin e kushteve për pjesëmarrje në gara, të përcaktuara me Ligje, akte nënligjore, Rregulla të FIBA-s, Propozicione të Garave dhe Vendime të Bordit. Nëse ekipi deklaron se nuk do të marrë pjesë në gara ose nuk deklarohet deri në afatin e caktuar nga Bordi i FBK-së për pjesëmarrje në gara, Bordi mund t'i caktojë ekipit afat plotësues për paraqitje në gara.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Ekipi i cili tërhiqet nga garat pas paraqitjes, bie në një rang më të ulët se rangun në të cilin është dashur të luajë.

Ekipi me formularin e paraqitjes, duhet ta dorëzojë edhe vendimin e Komisionit të Garave për miratimin e objektit sportiv në të cilën do t'i zhvillojë ndeshjet.

Ekipi i cili nuk garon një edicion të garave ose tërhiqet nga garat gjatë edicionit dhe nuk paraqitet për edicionin e ri të garave, fshihet nga regjistri i ekipeve dhe i humb e drejtat të cilat i takojnë ekipeve të regjistruara.

## Neni 29

Federata e Basketbollit e Kosovës është e liruar nga çdo përgjegjësi për organizimin e ndeshjeve kampionale.

## Neni 30

Me qëllim të ruajtjes së integritetit sportiv të garave të basketbollit, FBK ka të drejtë të intervenojë dhe të marrë hapa konkretë në çdo situatë, në të cilën një person është në pozitë që të ndikojë në udhëheqje, administratë të më shumë se një klubi.

## Neni 31

Asnjë ekip i cili merr pjesë në gara nën organizimin e FBK-së nuk mundet të jetë aksionar në klubin tjetër. Asnjë person fizik ose juridik nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë, në çfarëdo cilësie të marrë pjesë në udhëheqjen administrative ose sportive apo financiare të ndonjë ekipi tjetër, në rang të njëjtë garash.

Pronari i ekipit privat nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë të jetë aksionar në dy klube.

Përjashtim nga paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni, bëjnë rastet kur kemi të bëjmë me ekipet e gjinive të ndryshme.

## Neni 32

Skuadra e cila do të paraqitet me lojtarë të regjistruar në mënyrë jo të rregullt apo të paregjistruar me lojtarë të cilët janë nën masën e suspendimit apo të vuajtjes së dënimit, humb ndeshjen me rezultat zyrtar 2:0 dhe nuk merr pikë të paraparë për humbje.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





### Neni 34

Ekipi i cili është i dënuar me dënim të paraqitjes në ndeshje, nuk guxon të paraqitet dhe humb ndeshjen me rezultat zyrtar 2:0 dhe nuk merr pikë të paraparë për humbje.

### Neni 35

Ekipi i cili pa arsye nuk paraqitet në ndeshje, humb ndeshjen me rezultat zyrtar 20:0 dhe nuk merr pikë të paraparë për humbje.

### Neni 36

Ekipi që në një edicion garues humb dy (2) ndeshje me rezultat zyrtar do të largohet nga garat e mëtutjeshme dhe në vitin e ardhshëm garues nuk mund të paraqitet në të njëjtën nivel të garave.

### Neni 37

Ekipi që e braktisë në mënyrë arbitrare fushën e lojës para përfundimit të ndeshjes dhe nuk kthehet për vazhdimin e ndeshjes pas kohës së Time-Out të mbetur për atë periudhë apo në ftesë të gjyqtarit të parë, do të largohet nga garat e mëtutjeshme dhe në edicionin e ardhshëm garues do të bëjë gara në një shkallë më të ulët të garave.

### Neni 38

Nëse ekipi pa arsye nuk paraqitet për zhvillimin e ndeshjes së play-offit apo "më i mirë nga tri-pesë ndeshje" dhe në mënyrë arbitrare braktisë fushën dhe nuk kthehet për të vazhduar ndeshjen në ftesë të gjyqtarit të parë, i humb të gjitha ndeshjet në fazën e garave të play-off-it dhe në edicionin e ardhshëm garues do të bëjë gara në një shkallë më të ulët të garave.

### Neni 39

Nëse ekipi pa arsye nuk paraqitet për zhvillimin e ndeshjes së play-offit apo e braktisë ndeshjen "më i mirë nga pesë ndeshje" (ndeshja do të regjistrohet 20:0 në favor të ekipit kundërshtar) do të dënohet me 5.000€, kurse me rastin e përsëritjes (gjatë një edicioni) do të dënohet me 10.000€ dhe i humb

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





të gjitha ndeshjet në fazën e mbetur të garave të play-off-it dhe në edicionin e ardhshëm garues do të bëjë gara në një shkallë më të ulët të garave.

#### Neni 40

Nëse skuadra është larguar nga gara për shkak të dy (2) ndeshjeve të humbura me rezultat zyrtar (0:20) ose i braktisë garat dhe deri në çastin i ka zhvilluar gjysmën ose më tepër së gjysmën e ndeshjeve rezultatet e arritura janë të vlefshme, ndërsa ndeshjet vijuese regjistrohen me rezultat zyrtar 2:0 në të mirë të skuadrave kundërshtarë. Nëse skuadra i ka zhvilluar më pak se gjysmën e ndeshjeve, atëherë rezultatet e arritura anulohen (fshihen) dhe të gjitha regjistrohen me rezultat zyrtar 2:0 në të mirë të skuadrave kundërshtarë.

#### Neni 41

Dispozitat e cekura në nenet 34, 35, 36 dhe 37 do të zbatohen edhe nëse ekipi do t'i braktisë garat e mëtutjeshme.

#### Neni 42

Nëse vëzhguesi dhe gjyqtarët marrin vendim mbi ndërprerjen e ndeshjes pasi nuk eksitojnë kushtet mbi vazhdimin e saj për shkak të tollovisë (tifozeve) të shkaktuara, atëherë ndeshja regjistrohet me rezultat zyrtar 20:0 në të mirë të skuadrës mike, ndërsa skuadrës vendase i takon zero (0) pikë, me përjashtim nëse në mënyrë të pakontestueshme vërtetohet se ndërprerja është shkaktuar me fajin e skuadrës mike. Në këtë rast skuadra mike e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 0:20 dhe i takon zero (0) pikë. Ndeshja e ndërprerë për shkak të incidentit të shkaktuar nga ana e lojtarëve dhe përfaqësuesve zyrtarë të ndeshjes, do të regjistrohet me rezultat 2:0 kundër ekipit që ka shkaktuar ndërprerjen e ndeshjes dhe nuk merr pikë të paraparë për humbje.

#### Neni 43

Nëse skuadra gjatë lojës mbetet me më pak se dy (2) lojtarë në fushë e humb ndeshjen për shkak të mos përfundimit të lojës. Nëse skuadra, e cila në këtë mënyrë e fiton ndeshjen nuk udhëheq në rezultat, atëherë ndeshja regjistrohet me rezultat 2:0 në të mirë të saj.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Nëse skuadra e cila në këtë mënyrë e fiton ndeshjen udhëheq në rezultat, atëherë rezultati deri në kohën e ndërprerjes mbetet i vlefshëm. Skuadra e cila e humb ndeshjen në këtë mënyrë e fiton një (1) pikë në tabelën e klasifikimit.

#### Neni 44

Nëse Komisioni i Garave (organi i cili udhëheq garat), në procedurën e zbatuar, në mënyrë të pakontestueshme e vërteton se rezultati i ndeshjes në mes të dy skuadrave është kurdisur, atëherë të dyja skuadrat largohen nga garat dhe bien në një nivel më të ulët të garave.

#### Neni 45

Ekipet janë të obliguara që dënimet me të holla (monetare) të publikuara në informatorë t'i paguajnë në llogarinë e FBK-së në afat të caktuar pas publikimit të dënimeve në informatorin, që e boton Komisioni i Garave i rangut përkatës.

Nëse obligimet financiare të klubit nuk përmbushen në afatin e caktuar, klubi automatikisht do të suspendohet dhe nuk ka të drejtë paraqitjeje deri në përmbushjen e obligimeve financiare.

Gjatë kohës së suspendimit të gjitha ndeshjet do të regjistrohen me rezultat zyrtar për skuadrën kundërshtare dhe nuk merr një (1) pikë të paraparë për humbje.

Në rast se dy ekipe nuk i kanë përmbushur obligimet financiare dhe të njëjtat duhet të zhvillojnë ndeshjen në mes veti, do të suspendohen deri në përmbushjen e obligimeve, ndeshja do të regjistrohet me rezultat 2:0 kundër të dy ekipeve dhe nuk do të marrin një (1) pikë të paraparë për humbje.

#### Neni 46

Ekipi i cili nuk do t'i përmbushë obligimet financiare ndaj FBK-së të shqiptuara nga Komisioni i Garave, apo organeve tjera të FBK-së, nuk mund të garojë në edicionin e ardhshëm, gjegjësisht derisa t'i përmbushë të gjitha obligimet financiare.





## 7. PERSONAT ZYRTARË NË NDESHJE

### Neni 47

#### Vëzhguesi, Gjyqtarët dhe Gjyqtarët ndihmës

Personat zyrtarë në ndeshje janë Vëzhguesi, Gjyqtarët dhe gjyqtarët ndihmës. Për ndeshjet kampionale dhe të Kupës, Komesari i Garave bën delegimin e Vëzhguesit të ndeshjes nga lista e aprovuar e vëzhgueseve nga ana e Bordit të FBK-së në propozim të Komesarit të Garave. Vëzhguesi i ndeshjes përfaqëson organin i cili udhëheq me gara - Komisionin e Garave.

Obligim i vëzhguesit të ndeshjes është që të kontrollojë zbatimin e dispozitave të parapara për zhvillimin e ndeshjes, kurse në bashkëpunim me gjyqtarët duhet të sigurojë që ndeshja të zhvillohet në kushte të rregullta. Për ndeshjet kampionale dhe të Kupës, Komesari i Garave bën delegimin e gjyqtarëve për ndeshje, nga lista e gjyqtarëve e aprovuar nga ana e Bordit të FBK-së, në propozim të Shoqatës së Gjyqtarëve.

Gjyqtarët janë të autorizuar për marrjen e vendimeve lidhur me Rregullat e lojës së basketbollit të lëshuar nga FIBA.

Gjyqtarët ndihmës në ndeshje Kampionale dhe të Kupës i cakton ekipi vendas.

Komisioni i Garave mund të caktojë kontrollin e gjykimit të ndeshjes për të cilën mendon se ka nevojë.

### Neni 48

#### Personat zyrtarë të ekipeve

Persona zyrtarë të ekipeve në ndeshje, janë të gjithë ata persona të cilët janë të licencuar si të tillë, nga organi kompetent i garave. Personi zyrtar (drejtori sportiv i ekipit), i licencuar nga organi kompetent i garave mund të ulet në bankën për lojtarët rezervë, në bazë të dispozitave të propozicioneve të garave. Personi zyrtar i ekipit vendas është i obliguar që dy (2) orë para fillimit të ndeshjes të jetë prezentë në palestrën sportive, në të cilën do të zhvillohet ndeshja.





## 8. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 49

Të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë paraparë me këtë rregullore dhe Rregullat zyrtare të basketbollit, do të përcaktohen me Propozicionet e Garave.

### Neni 50

Ndërrimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje miratohen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të tyre.

### Neni 51

Interpretimin e kësaj Rregulloreje e jep Bordi i FBK-së, në mënyrë direkte apo nëpërmjet të Komisioneve të tij.

### Neni 52

Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga ana e Bordit të FBK-së.

Arben **FETAHU**  
Kryetar

28 korrik 2022, Prishtinë

Federata e Basketbollit e Kosovës

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

